
STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
AUDACE Sh.p.k.

B

Albani
1

Sot me date 15/08/2024 ,individet e meposhtem , ortaket

EDMOND ULQINAKU

- Atesia: Adnan
- Amesia: Fatime
- Lindur: 31/03/1988 - Shkoder
- Banues: Rr. Bashkimi, 1 – 4001 – Shkoder
- ID: I80331106E

ARJOLA DUMA

- Atesia: Besim
- Amesia: Shemsie
- Lindur: 10/09/1984 - Shkoder
- Banues: Rr. A.SH. Gjeçovi, p.n – 4001 – Shkoder
- ID: I45910108I

KAPITULLI I

**EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE,
SELIA, TERRITORI**

NENI 1

FORMA DHE EMRI

1.1 Shoqëria ka formën e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me initiale Sh.P.K., të cilat vijnë menjëhere pas emrit të shoqërise. Kjo shoqëri i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërise.

1.2 Emri i shoqërise është **AUDACE Sh.p.k** Forma dhe emri i shoqërise mund të ndryshohen me vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortakeve.

NENI 2

BAZA LIGJORE

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, në përputhje me legjislacionin shqiptarë në përgjithsi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në përputhje me marreveshjet ndërkombetare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërise.

NENI 3

SELIA

Selia e shoqërise është në adresën:

**Shkoder Shkoder SHKODER Rruga Komiteti i Kosoves, godine 2-kateshe,
kati i I-re, nr.9**

Me adresën e mësipërme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim të Asamblese së Ortakeve mund të hapen degë, filiale, agjensi ose përfaqesi brenda territorit të Republikës së Shqipërise sipas fushave në të cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4 TERRITORI

4.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj lirisht si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

4.2 Shoqëria mund të krijojë zyra ose përfaqësi të saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyrat, filialet ose përfaqësitë e shoqërisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

KAPITULLI II OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria ka si objekt:

Bar-Restorant

BnB (Bed and Breakfast)

Hotel

Agjenci Imobiliare - Shitje dhe Blerje Pronash

Agjenci Eventesh, Dekorimesh dhe Dasmash

Marketing dhe Reklamim

Zhvillim Faqesh Web

Programim Software

Shitje dhe Blerje Makinash

Makina me Qera

Bicikleta me Qera

Shërbime Pastrimi

Mini-market

Shitje Produktesh dhe Online

Agjenci Udhëtimi

Shërbime Konsulence

Catering

Lavanderi – Pastrim Kimik

Studio arkitekture

Studio fotografi

NENI 6 KOHEZGJATJA



Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të papërcaktuar në kohë.

KAPITULLI III
KONFIDENCIALITETI,
DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TE TRETËT

NENI 7
KONFIDENCIALITETI

Ortakët e shoqërise si dhe personat e tjere të pranuar në shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhe, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

NENI 8
DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TE TRETËT

Të gjithë aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët, si letrat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojnë lexueshem emrin, logon e shoqërise dhe pas tij fjalet “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet “Sh.P.K.”, si dhe emrin e administratorit ose të administratorëve.

KAPITULLI IV
KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET,
PJESËT DHE TRASFERIMI I TYRE

NENI 9
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është në vlerën 100.000 (njqind mije) leke, I perbere nga nje kuote e nare si me poshte vijon, Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

Ortakët Edmond Ulqinaku dhe Arjola Duma, në vlerë kapitali para 100.000 leke

Nr. I pergjithshem i kuotave 1 (nje), pjesmarrja ne perqindje =

1- EDMOND ULQINAKU 51 % = 51000 (pesedhjetë e një mije)LEK


2- ARJOLA DUMA 49% = 49.000 (dyzet e nente mije) LEK

NENI 10

TE DREJTAT E ORTAKEVE NE LIDHJE ME KAPITALIN

10.1 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar te shoqërise kryhet sipas vendimit te asamblese se pergjithshme te ortakeve me shumicen e $\frac{3}{4}$ (tre te katerve) te kuotave te kapitalit themeltar te shoqërise.

10.2 Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar, i perket ortakeve e drejta me opcion mbi kapitalin ne zmadhim, ne proporcion me kuoten e kapitalit qe kane ne pronesi.



10.3 Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e shoqërise shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e saj themeltar.

10.4 Secili ortak ushtron të drejtat pasurore të parashikuara nga ligji në proporcion me kuotat e pjesëmarrjes në kapital.

10.6 Ortakët që nuk marrin pjesë në administrimin e shoqërise kanë të drejtë t'i kërkojnë organit administrativ informacione mbi aktivitetin e shoqërise, si dhe të konsultojnë dokumentet kontabel e dokumentet e tjera që lidhen me administrimin e saj.

NENI 11

FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKUT

Fusha e autoritetit të ortakëve, përqindja e fitimeve ose humbjeve do të kene si kriter bazë kontributin e çdo ortaku në kapitalin e shoqërise, si dhe kompetencat që gezon ortaku në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuar në këtë statut.

NENI 12

FINANCIMI I SHOQERISE

12.1 Organi administrativ, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të kërkoje nga ortakët fondet e nevojshme për arritjen e objektit të shoqërise.

12.2 Financimet e mëtejshme të ortakëve do të jene me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit jepen këto fonde.

NENI 13

TRASFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

13.1 Kapitali themeltar i shoqërise ose pjesë të tij mund të transferohen lirisht mes ortakëve të shoqërise. Kapitali themeltar i shoqërise ose pjesë të tij mund të transferohen tek persona të tretë vetëm pasi ortakët e shoqërise në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar zyrtarisht kanë refuzuar ushtrimin e të drejtes së parablerjes.

13.2 Transferimi i kapitalit themeltar të shoqërise ose i pjeseve te tij tek persona të tretë behet vetëm në këtë mënyre:

- Oferta per shitje u drejtohet te gjithe ortakëve me shkrim;
- Oferta duhet te percaktoje numrin e kuotave qe shiten dhe çmimin e tyre;

Nese ortakët e shoqërise brenda 3 (tre) muaj nga oferta me shkrim nuk pranojne blerjen e kuotave te ofruara me çmimin e percaktuar, atehere konsiderohet se ata lejojne shitblerjen tek te tretet.

13.3 Kapitali themeltar eshte lirisht i trashgueshem ne rruge trashegimie. Bashkeshorti, paraardhesit dhe pasardhesit mund te behen ortakë nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar sipas kushteve qe lejohen ne ligj.

13.4 Klauzolë miratimi. Nëse asnje ortak nuk do të ushtrorë të drejtën e parablerjes ne kohe dhe sipas kushteve të parashikuar për transferimin e kuotave apo të drejten e opcionit, kalimi i kuotave nuk do të mund të bëhet pa pëlqimin e Asamblese se Ortakëve që vendos për pranimin e transferimit te nje person i tretë.

Ortakët mbledhen në (Asamble) ditë, por jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, nëpërmjet Asamblese të Zakonshme të Ortakeve, duke vendosur me votën pro (ne favor) me të paktën gjysmen e kapitalit themeltar.

13.5 Pelqimi mund te refuzohet vetem kur bleresi nuk jep garanci te mjaftueshme rreth kapaciteteve financiare ose për kushtet objektive ose për aktivitetin që kryen, të tilla që hyrja e tij në shoqëri mund të jenë e dëmshme për arritjen e objektivave nga shoqëria ose konflikt me interesat e shoqërisë apo te ortakeve te tjerë.

Asambleja e Ortakeve duhet të njoftojë me shkrim në adresën që rezulton vendimin për miratim.

Nëse brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës për miratim ortaku kërkeses qe nuk ka marrë asnjë komunikim miratimi do të konsiderohet si i dhene dhe ortaket mund të transferojne kuoten e tyre.

13.6 Nëse miratimi i mohohet do të prezantohet një tjetër blerës. Për këtë qëllim, Asambleja e Ortakeve duhet të tregojë në letrën e refuzimit emrin e blerësit të propozuar; transferimi duhet të plotësohet me të njëjtat kushte të përcaktuara në kërkesën për miratim nga ana e aplikantit brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve pas marrjes së komunikimit të fundit.

Përndryshe, ortaku do të jetë i lire për të shitur pjesëmarrjen e tij personit që konsideron me te përshtatshem.

KAPITULLI V

ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 14

ORGANET DREJTUESE

14.1 Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Ortakëve dhe Administratori. Për efekt të ndryshimeve që mund të pësoje shoqëria në të ardhmen dhe shtimit të numrit të ortakëve, këtu e në vazhdim organit zotërues të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise do ti referohemi me termin Asamble e Ortakëve.

14.2 Shoqëria mund të emeroje më shume se një Administrator. Ne çdo rast, kur termi "Administrator" perdoret per te percaktuar Administratorin e shoqerise **AUDACE Sh.p.k**, ky term nenkupton te gjithe Administratoret e saj sado qofshin keta ne numer.

14.3 Pervec organeve te parashikuara me siper Asambleja e Ortakeve mund te krijoje edhe organe te tjera drejtuese, ne aktet e krijimit te ketyre organeve do te percaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre.

14.4 Administrator i shoqerise per nje periudhe 5 (pese) vjeçare eshte emeruar :

1. Edmond Ulqinaku, shtetas shqiptar i dtl. 31.03.1988, nr. Personal I80331106E

KAPITULLI VI

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

NENI 15

VENDIMET E ASAMBLESE TE ORTAKEVE

15.1 Asambleja e Ortakeve vendos per çeshtjet qe ligji apo ky statut i rezervon ketij organi, si dhe per çeshtjet per te cilat, organi administrativ kerkon mendimin apo miratimin e ortakeve.

15.2 Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 50 % te kuotave te kapitalit themeltar.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, sipas ligjit mbi shoqerite tregtare, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se 75 % te numrit total te kuotave te kapitalit themeltar jane te pranishem dhe vendosin me voten e $\frac{3}{4}$ (tre te katertave).

NENI 16

KONSULTIMI ME SHKRIM I ORTAKEVE

16.1 Ne perputhje me dispozitat e statutit, vendimet e ortakeve mund te merren pas nje konsultimi me shkrim qe organi administrativ i drejton secilit prej tyre. Ne kete rast, organi administrativ i komunikon ortakeve tekstin e projekt-vendimit qe do te merret dhe i kerkon te shprehin vullnetin e tyre ne lidhje me kete çeshtje.

16.2 Vendimet e marra ne kete menyre jane te vlefshme kur vendimi merret nga shumica qe ligji apo ky statut kerkon per ate çeshtje.

NENI 17

MENYRA DHE VENDI I THIRRJES I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

17.1 Asambleja e Ortakeve thirret prane selise se shoqerise, apo ne ndonje vend tjeter brenda Republikes se Shqiperise, nepermjet nje njoftimi me shkrim edhe nepermjet postes elektronike (E-mail), duke e konfirmuar marrjen, qe iu dergohet ortakeve nga Kryetari i Asamblese se Ortakeve dhe / ose Organi Administrativ.

17.2 Njoftimi i thirrjes se mbledhjes se asamblese duhet te kryhet 15 (pesembedhjete) dite perpara dates se mbledhjes dhe duhet te percaktoje shprehimisht daten, oren, vendin si dhe rendin e dites. Ne rast pamundesie apo mosveprimi nga ana e organit administrativ, mbledhja e asamblese se ortakeve mund te thirret nga esperti kontabel i autorizuar, nese ka te tille, ose nga nje apo me shume ortake, te cilet perfaqesojne jo me pak se 10% te kapitalit te shoqerise.

NENI 18

KRYETARI I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

18.1 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve emeron Kryetarin e Asamblese.

18.2 Kryetari i Asamblese verifikon thirrjen dhe mbledhjen e rregullt te Asamblese se Ortakeve, verteton identitetin apo legjitimitimin e perfaqesuesit te ortakeve dhe drejton zhvillimin e rregullt te mbledhjes.

NENI 19
PJESEMARRJA NE VENDIME

Çdo ortak ka te drejten e nje vote per çdo kuote te kapitalit themeltar te shoqerise qe ai zoteron. Nje ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjen e asamblese nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete, nepermjet nje akti perfaqesimi me shkrim.

NENI 20
KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

20.1 Asambleja e Ortakeve mund te jete e zakonshme dhe e jashtezakonshme, kjo ne varesi te çeshtjes per te cilen eshte thirrur.

Vendimet e Asamblese se Zakonshme te Ortakeve merren me shumice te thjeshte te votave te ortakeve. Vendimet e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve merren me nje shumice te cilesuar prej $\frac{3}{4}$ (tre te katertave) te votave te ortakeve te shoqerise. Per çfare nuk eshte pasqyruar ne kete nene, Asambleja e Ortakeve te shoqerise vendos ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14. 04. 2008.

20.2 Kompetencat e Asamblese se Zakonshme te Ortakeve do te jene:

- Vendos per perpilimin ose miratimin e rregulloreve per shoqerine apo per fusha te veçanta te veprimtarise.
- Vendos per ndryshimin e selise se shoqerise.
- Vendos per krijimin e zyrave ose te perfaqesive si dhe per krijimin e shoqerive ose te ortakerive me persona te tjere fizike apo juridike.
- Vendos per politiken afariste te shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saj.
- Emeron dhe shkarkon Administratorin e shoqerise, ekspertin kontabel, likujdatorin duke percaktuar dhe detajuar kompetencat e tyre, te drejtat, detyrimet, kohezgjatjen ne detyre, dhe shperblimin e tyre.
- Vendos ne lidhje me krijimin e organeve te tjera drejtuese qe mund t'i nevojiten shoqerise duke percaktuar ne aktet e krijimit te ketyre organeve, kohezgjatjen dhe kompetencat e tyre, per emerimin e personave drejtues te ketyre organeve.
- Asambleja e Ortakeve marrjen e vendimeve e kryen vete dhe nuk ben delegimin e vendimarrjes te asnje organ tjeter. Asambleja e Ortakeve vendos edhe ne lidhje me krijimin e sektoreve te veçante te veprimtarise se shoqerise.
- Shqyrton dhe miraton bilancin vjetor.
- Miraton tarifat e sherbimeve te shoqerise.
- Miraton pagat e te punesuarve ne shoqeri.

20.3 Kompetencat e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve jane:

- Vendos ne lidhje me zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
- Vendos ne lidhje me kohezgjatjen e shoqerise si dhe per mbarimin e likujdimin e saj.
- Vendos per ndryshimin e emrit te shoqerise.
- Vendos ne lidhje me ndryshimin e statutit te shoqerise.
- Vendos per ndryshimin e formes, per ndarjen e shoqerise si dhe per bashkimin e saj me shoqeri te tjera.



8

- Percakton llojin e fondeve te ndryshme dhe masen e tyre, percaktimin e dividendit, marrjen dhe dhenien e huave, kredive, borxheve.
- Realizon marredheniet me te rendesishme ekonomike dhe financiare te shoqerise me persona te tjere fizik apo juridik, vendas apo te huaj.
- Vendos ne lidhje me transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise.

20.4 Pervec kompetencave te lartpermendura, te cilat jane ekskluzive per te, Asambleja e Ortakeve ushtron çdo kompetence qe ia njeh ligji.

20.5 Asambleja e Ortakeve ne rastet kur nuk ka emeruar Administrator, kryen dhe kompetencat qe ne kete Statut jane percaktuar per kete te fundit. Gjithashtu Asambleja e Ortakeve mund te kufizojë Administratorin ne ushtrimin e kompetencave te tij.

NENI 21

ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ


21.1 Kompetencat e Administratorit ose te Administratoreve, te cilet mund edhe te mos jene ortake te shoqerise, ne menyre konkrete dhe te detajuar percaktohen ne aktin e tyre te emerimit. Vec te tjerave qe mund te detajohen ne kete akt, Administratori ka edhe keto kompetenca:

- Kujdeset per funksionimin e perditshem normal te shoqerise ose te nje pjese te aktivitetit ekonomik dhe financiar te saj, sipas percaktimit ne aktin e emerimit.
- Pergatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ia paraqet Asamblese se Ortakeve per shqyrtim.
- Koordinon veprimtarine e personave te punesuar ne shoqeri.
- Ndjek problemet e shoqerise ne marredhenie me organet shteterore ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.
- I propozon Asamblese se Ortakeve tarifat e sherbimeve dhe pagat per personelin e punesuar ne shoqeri.
- I propozon Asamblese se Ortakeve rregulloren e shoqerise.
- Administratoret kane te drejte te gjithë sebashku ose vecmas nga njeri tjetri te perfaqesojne shoqerine ne lidhje me te tretet.

21.2 Administratori ose Administroret jane pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit ose per faje te kryera gjate ushtrimit te administrimit te shoqerise. Pergjegjesia eshte individuale ose solidare, kjo ne varesi te rrethanave dhe te menyres se si eshte vepruar, pra individualisht ose solidarisht.

21.3 Administratori ose Administroret nuk jane pergjegjes ndaj shoqerise ose te treteve per konfliktin e interesit qe mund te krijohet duke zhvilluar pozicione te ndryshme ose te ngjashme ne shoqeri dhe organizma te ndryshem.

21.4 Shoqeria mund te administrohet nga nje administrator i vetem ose nga shume administratore, nga dy deri ne nente anetar, sipas krijimit nga akti i emerimit. Ne rastin e shume administratoreve, ata mund te formojne nje trup kolektiv, keshilli i administrimit, ose nje trup jo kolektiv, anetaret e te cilit mund te veprojne ne ane te perbashketa, te ndara, ose te miksuara ne baze te asaj qe do te krijohet nga akti i emertimit.

21.5 Nuk mund te emertohet administrator ose perfaqesues dhe, nese emertohet, bie nga zyra e tij, ndalohet, i paafti, deshtuesi ose kush eshte denuar me nje denim, edhe perkohesisht, nga zyrrat publike ose paaftesia ne ushtrimin e zyrove ekzekutive.

21.6 Administratoret kane te gjitha kompetencat e drejtimit te zakonshem ose te jashtezakonshem te shoqerise per zbatimin e qellimit te saj, pervec kompetences se dhene nga vendimi i ortakeve ne perputhje me ligjin. Cdo administrator ose perfaqesues mund te heqi dore ne cdo moment, duke derguar nje njoftim me poste tek administratoret e tjere, ne rastin e shume administratoreve, dhe cdo ortakeve. Doreheqja ka efekt te menjehershem nese mbetet ne detyre shumica e administratoreve ose perfaqesuesve. Ne rast te kundert, ajo ka efekt nga momenti qe emerohet administratori ose perfaqesuesi i ri, vetem nese, te mbetet te pakten nje administrator ose perfaqesues, doreheqja do te pranohet me shkrim nga ana e cdo ortaku tjeter, ne kete rast, komunikimi i administratorit qe jep doreheqjen nderpritet menjehere.

21.7 Cdo administrator ose perfaqesues pushohet nga detyra per skadencen e afatit te themeluar nga akti i emertimit, ne vdekje, per paraqitjen e situatave qe sjellin padrejtesi ose papajtueshmeri per detyren, qofte kjo edhe pa shkak, me vendim te ortakeve. Ne kete rast, nderprerja e kontrates verifikohet kur vendimi per terheqje, i eshte njoftuar nepermjet postes ose me dore administratorit ose perfaqesuesit te revokuar. Revokimi, ne mungese te nje shkak, nuk sjell asnje te drejte per te kompesuar demet.

21.8 Keshilli i Administrimit. Keshilli administrimit perbehet nga nje numer anetaresh i vendosur nga akti i emertimit, nga te cilet eshte zgjedhur presidenti dhe zevendes presidenti, nese nuk eshte bere nga vendimi i ortakeve. Keshilli i administrimit, mbledh si ne zyren qendore ashtu edhe tjeterkund, sa here e gjykon te nevojshme, te pakten nje keshilltar ose, nese eshte emeruar, kryetari i komunes ose auditori. Procedura ne mbledhjet e keshillit mund edhe te behet nepermjet mjeteve te telekomunikimit, me kushtin qe te gjitha pjesemarresit mund te identifikohen dhe ti lejohet qe te ndjekin diskutimet, te marrin, te transmetojne ose te shohin dokumente, te nderhyjne duke folur ne kohe reale mbi te gjitha argumentet. Per vlefshmerine e vendimeve te keshillit duhet te jene te pranishem dhe me vota te favorshme nga shumica e anetareve.

Vendimet e administratorit mund edhe te jene te miratuara nga konsultimet me shkrim, ose pelqimin e shprehur me shkrim te derguara me telegram, telefaks ose e-mail brenda periudhes se specifikuar ne kerkese. Ne kete rast aplikohen te gjitha dispozitat e diktuar lidhur me vendimet e ortakeve nga paktet sociale prezente.

Brenda kufijve ligjore, keshilli i administrimit mund te delegoje fuqine e tij, te gjithen ose nje pjese, tek nje ose disa anetareve te tij.

21.9 Administratori **Edmond Ulqinaku** ka kompetencat e meposhtme;

- te drejten per te perfaqesuar shoqerine ne cdo institucion shteteror ose privat pa kufizime per te bere te gjitha deklaratat ose rregjistrimet e deetyrueshme ose vullnetare sipas legjislacionit te aplikueshem shqiptar, per shembull zyrrat tatimore- pagesa tatimore, sigurimet shoqerore, zyra ose agjencite doganore, Qendra Kombetare e Licencimit dhe/ose Qendra Kombetare e Biznesit, zyra e punesimit pagesa e pagave etj, te cilat kane te bejne me veprimtarine e zakonshme te kompanise.

- perfaqesim ne cdo banke te nivelit te dyte qe vepron ne Shqiperi ku shoqeria llogari rrjedhese ose para ndonje institucioni shteteror, per pagesen e taksave, kontributet e sigurimeve shoqerore, tatimin mbi



vleren e shtuar, tatimin mbi te ardhurat, tatimin ne burim, taksat vendore, pagesen e pagave te punonjesve, pagesa e qerese si dhe cdo detyrim te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi, i cili ne cdo rast duhet te behet me transferte bankare nga llogarite ekzistuese te shoqerise ne keto institucione.

- menaxhimin e puneve te pergjithshme te kompanise, duke pasur parasysh ne vecanti nevojat e mirembajtjes se objekteve, blerjen e materialeve kancelari ose te konsumit per kryerjen e veprimtarise.

KAPITULLI VII **KONTROLLI KONTABEL,** **BILANCI, DIVIDENTET**

NENI 22

KONTROLLI KONTABEL

Kontrolli i jashtem kontabel i shoqerise kryhet nga eksperte kontabel te autorizuar, sipas legjislacionit ne fuqi. Asambleja e Ortakeve do te emeruje nje apo me shume eksperte kontabel ne ato raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kerkohet ne baze te ligjit.

NENI 23

BILANCI DHE REZERVAT

23.1 Bilanci mbyllet deri me 31 mars te vitit pasardhes dhe perfshin periudhen 01 janar deri 31 dhjetor te vitit. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiare dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar, i paraqiten per shqyrtim asamblese se ortakeve, e cila vendos mbi miratimin, ndryshimin ose rrezimin e ketyre akteve, kur e konsideron te nevojshme Asambleja e Ortakeve mund te beje rekomandimet e nevojshme ne lidhje me ceshtjen ne diskutim.


23.2 Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori i vetem merr masat e nevojshme per hartimin e projekt-bilancit te aktivitetit per vitin financiar te mbyllur, ne menyre qe Asambleja e Ortakeve te vendose mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme te tij brenda afateve te percaktuara nga ligji.

23.3 Asambleja e Ortakeve vendos mbi ndarjen ndermjet ortakeve te shumave qe rezultojne si fitime sipas bilancit te aprovuar rregullisht, pasi nga keto shuma te jene zbritur humbjet e mundshme te viteve te meparshme, si dhe te jene lene menjane shumat e nevojshme per krijimin e rezerves ligjore. Rezerva ligjore krijohet vit pas viti nepermjet lenies menjane te nje shume te barabarte me 5 % te fitimit neto te realizuar gjate secilit vit financiar, deri sa te arrihet nje shume e barabarte me 10 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

23.4 Asambleja e Ortakeve ne cdo moment mund te vendose krijimin e rezervave te tjera, si dhe masen e tyre.

KAPITULLI VIII **MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE,** **LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE**

NENI 24



MBARIMI

Shoqeria mbaron me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve ose kur ka nje prishje te parakohshme per arsyet e parashikuara ne ligj.

NENI 25 LIKUJDIMI

25.1 Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi Asambleja e Ortakeve cakton nje ose disa likujdues, te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitet dhe pasivitet te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

25.2 Ne fund te procesit te likujdimit, Asambleja e Ortakeve vendos mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit.

25.3 Mbas pagimit te kreditoreve Asambleja e Ortakeve mban pjesen e mbetur te kapitalit qe u shperndahet ortakeve.

NENI 26 LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

26.1 E drejta e largimit lejohet ne rastet e parashikuara me ligj.

Njoftimi i largimit duhet ti dergohen shoqerise me shkrim dhe duhet te perfshije emer mbiemer te ortakut qe largohet, vendbanimin, per komunikimet e nevojshme mbi proceduren e largimit dhe numrin e kuotave ne lidhje me te cilat synon te largohet motivimet perkatese.


Ortakët që largohen nga shoqëria kanë të drejtë të marrin një rimbursim të kuotave në proporcion të kapitalit të shoqërise. Për këtë qëllim është përcaktuar duke marrë parasysh vlerën e tij të llogaritur në bazë të kapitalit neto.

26.2 Shlyerja e kuotave për të cilën është ushtruar e drejta e largimit duhet të bëhet brenda 90 (nentedhjetë) ditëve nga komunikimi që i bëhet shoqërise. Ajo gjithashtu mund të bëhet me anë të blerjes nga ortakët e tjerë në proporcion me pjesëmarrjen e tyre ose nga një palë e tretë të identifikuar në mënyrë unanime nga ortakët.

Për këtë qëllim, administratorit i kërkohet që të njoftojë ortakët e tjerë mbi mbarëvajtjen e procedurës së largimit të ortakut, dhe t'ia ofrojë për shitje, në emër dhe për llogari të ortakut që largohet, pjesën mbi të cilën është ushtruar largimi, duke deklaruar çmimin e kuotes dhe afatin për pagesën e saj, jo më shumë se 3 (tre) muaj. Për shitjen zbatohen rregulla mbi ushtrimin e së drejtës të parablerjes në këtë Statut.

26.3 Ortakët duhet të informojnë shoqërinë për qëllimin e tyre për të blerë kuotat e ortakut që largohet ose emrin e palës së tretë blerëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e komunikimit nga shoqëria dhe qëllimin e ortakut për t'u larguar. Nëse oferta është pranuar nga shumica e ortakëve, pjesa e ortakut që largohet do të ndahet në proporcion midis ortakeve në bazë të kuotave përkatëse që kanë në kapitalin themeltare.

Nëse kjo nuk ndodh, rimbursimi do të bëhet duke përdorur rezervat e disponueshme ose në mungesë përkatësisht zvogëlimin e kapitalit; nëse nuk është e mundur një rimbursim i kuotave të ortakut që largohet, atëherë shoqëria vendoset në likuidim.



26.4 Përrjashtimi i ortakut mund të bëhet, në rast të vonesës apo pamundësisë së kryerjes të punës ose shërbimeve që mund të kryhen nga një ortakë.

Përrjashtimi duhet të përcaktohet me vendim të Asamblese së Pergjithshme të Ortakëve me tre të katërtat e votave.

Pas zbulimit të vendimit për të përrjashtuar ortakun, ky i fundit është i penguar për të ushtruar të drejtat shoqërore.

26.5 Për likuidimin e kuotës të ortakut që largohet, aplikohet procedura e rimbursimit e parashikuar për largimin, përrjashtuar këtu mundësia e shlyerjes së kuotës nëpërmjet reduktimit të kapitalit themeltare dhe likuidimin e mundshëm të shoqërisë.

Përrjashtimi mund të revokohet, derisa kuota e ortakut të përrjashtuar nuk i është rimborsuar.

KAPITULLI IX MOSMARREVESHJET DHE DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 27 ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Çdo mosmarreveshje a konflikt ne lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kesaj shoqerie, ortakët do te angazhohen se do ta zgjidhin me mirekuptim, dhe ne rast se kjo nuk arrihet kompetente per gjykimin e mosmarreveshjeve a konflikteve te mundshme do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Shkoder.

NENI 28 DISPOZITA TE FUNDIT

28.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statut dhe me ligjin shqiptare. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut, do te aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptare ne fushen e shoqerive tregtare si dhe legjislacioni shqiptare ne pergjithesi.

28.2 Shoqeria do te kete vulen, stemen, logon dhe faqen e internetit (website), format dhe madhesite do te percaktohen nga asambleja e ortakeve ne veçanti dhe me propozim te administratorit.

28.3 Ky statut është hartuar në 3 (tri) kopje,

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE



AUDACE Sh.p.k


Ortaket themelues

Edmond Ulqinaku

Edmond Ulqinaku



**Administratori
Edmond Ulqinaku**



Arjola Duma

Arjola Duma

